



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 373/1 prot.

Tiranë, më 27. 03. 2023

V E N D I M

Nr. 45, datë 27. 03. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 40 Regj., datë 08.03.2023, të shtetasit D. V., kundër Universitetit New York Tirana, me pretendimin e diskriminimit për “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, D. V., ka shpjeguar se prej datës 04.08.2016, ka lidhur një kontratë pune me Universitetin e New York-ut në Tiranë (në vijim UNYT).

Më datë 05.05.2021, ankuesi është njoftuar nga punëdhënësi i tij për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës si pasojë e:

- Veprimet në keqbesim dhe dëmtimit në mënyrë të qëllimshme të reputacionit të UNYT kundrejt European Education Audiovizual and Culture Executive Agency (EACEA) përmes dorëzimit pranë EACEA të pretendimeve financiare dhe akuzave të pabazuara kundrejt UNYT, në shkresën e titulluar “Detyrimet financiare të UNYT” bashkëngjitur raportit final të projektit Refugee Law, të dorëzuar më 12.12.2020. Kjo përbën një shkelje të qartë të parimit të mirëbesimit dhe ndikon negativisht në imazhin dhe reputacionin UNYT kundrejt EACEA.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³Subjekti ankues referon tek ky shkak Rezidenca fiskale e përcaktuar tek Neni 3, par. 2, ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, ku citohet se: “Individi, që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë të një periudhe tatimore”.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

- Mosdorëzimi i raportit përfundimtar të projektit Refugee Law, në përputhje me kërkesat e EACEA, që rezultoi në refuzimin e raportit përfundimtar nga UNYT.
- Mosparaqitja në seancën dëgjimore të datës 16.04.2021 të Këshillit të Etikës dhe mosparaqitja e dokumentacionit zyrtar justifikues për mungesën.
- Refuzimi i vazhdueshëm për t'u paraqitur në punë gjatë orarit zyrtar, pas kërkesës së Rektorit dhe Administratorit të UNYT, specifikisht me datat: 28.01.2021, 29.01.2021, 04.02.2021 dhe 05.02.2021.
- Përndjekjes së përsëritur dhe të vazhdueshme ndaj drejtuesve dhe rektoratit të UNYT përmes korrespondencave në postë elektronike duke krijuar një mjedis konfliktual, armiqësor dhe fyes në punë, me ndikim negativ dhe tek kolegët.
- Indicieve për angazhim në Shkollën Kombëtare të Avokatisë, pa marrë autorizim paraprak të Rektorit dhe refuzim për t'u përgjigjur lidhur me këtë çështje.
- Përpjekjeve për të marrë rimbursim financiar të pajustificuar me dokumentacionin përkatës.
- Publikimeve në emër të një institucioni të ndryshëm nga UNYT më 2019.
- Pretendimeve për pagesën nga ana e UNYT të znj. E. R., person i cili ju ka asistuar, por pa patur kompetencën e angazhimit të stafit akademik dhe pa marrë aprovimin paraprak nga Rektori i UNYT.

Përsa më sipër, subjekti ankues ka paraqitur ankesën pranë KMD-së me pretendimin se është akuzuar nga punëdhënësi për publikime në emër të një institucioni të ndryshëm nga UNYT dhe punësimin e tij me kohë të plotë edhe në një institucion tjetër arsimor, në shkelje të legjislacionit për arsimin e lartë. Sa i përket publikimeve, ankuesi thekson se ka marrë më parë miratimin e UNYT. Ndërsa, sa i përket akuzës për dypunësimin e tij, ai sqaron se i ka paraqitur punëdhënësit prova dhe fakte që ky pretendim nuk rezultoi i vërtetë, madje ka bërë me dije që një pjesë e stafit akademik rezultoi i dypunësuar në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe për këtë nuk është marrë asnjë masë.

Në këto kushte, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit gjatë marrëdhënieve të punës, duke u vënë në pozita të pafavorshme e të padrejta, në raport me kolegët e tij për shkak të rezidencës fiskale përcaktuar tek Neni 3, paragrafi 2, i ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për Tatimin mbi të Ardhurat”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Individi, që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë të një periudhe tatimore”*.

Pra sipas D. V., edhe pse kolegë të tij rezultojnë të punësuar si staf akademik me kohë të plotë jashtë vendit, UNYT ka marrë masë disiplinore vetëm për të, duke cituar si shkak rezidencën fiskale.

Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit ndaj tij, nga ana e Universitetit të New York-ut Tiranë, për shkak të rezidencës fiskale.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në informacionin e dërguar me anë të e-mail-it datë 18.03.2023, subjekti ankues ka bashkëlidhur dhe kopje të dokumentacionit poshtëcitur:

- Kërkesë Padi kundër Universitetit të New York Tirana, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistruar me nr. akti 8238, datë 26.10.2021, me objekt: *“Kundërshtimi i zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi...”*.

Në parashtrimet e tij në kërkesë padi, ankuesi në mes të tjerash ka pretenduar se është larguar në mënyrë të pajustificuar, duke cituar shprehimisht në faqen 37 se: *“...Duhet nënvizuar fakti që Komisioni i Etikës nuk ka marrë për bazë ankesën e paditësit, por është marrë vetëm me rastin e paditësit dhe kjo duket si një trajtim diferencial, i cili mund të konsiderohet kundër dinjitetit të paditësit, siç parashikohet në nenet 9 (6) dhe 32 të Kodit Shqiptar të Punës...”*.

Në nenin 9/6 *“Ndalimi i diskriminimit”*, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“6. Në zbatim të parimit për trajtim të barabartë, të gjithë punëmarrësit dhe çdo grup punëmarrësish duhet të trajtohen me të njëjtin respekt dhe kujdes dhe duhet të respektohen edhe rrethanat e tyre të veçanta.”*

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të depozituar si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues, për diskriminim, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu, evidentohet se subjekti ankues në bazën ligjore të kërkesë padisë ka cituar nenin 146 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur:

a) punëmarrësi ka pretendime që rrjedhin nga kontrata e punës;

b) punëmarrësi ka përmbushur një detyrim ligjor;

c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

d) për motive që lidhen me ushtrimin nga punëmarrësi, të një të drejte kushtetuese, por që nuk sjell shkeljen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës;

e) bëhet për motive të antarësimit ose jo të punëmarrësit në sindikatë të krijuar në bazë të ligjit ose për shkak të pjesëmarrjes së tij në veprimtari sindikale në bazë të ligjit;

f) Shuqizohet;

g) Shfuqizohet.

gj) bëhet në kundërshtim me parashikimet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 144, të këtij Kodi, lidhur me arsyet e zgjidhjes së kontratës së punës.

2. Nëse kontrata zgjidhet pa shkaqe të arsyeshme, punëmarrësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër punëdhënësit në gjykatë, brenda 180 ditëve nga dita e përfundimit të afatit të njoftimit. Në rastin kur motivi abuziv është zbuluar pas kalimit të këtij afati, punëmarrësi duhet të ngrejë padinë brenda 30 ditëve nga dita e zbulimit të këtij motivi.

3. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.”

Theksojmë se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuesit.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: “...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadija në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadiisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadiisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadiisë. Ai mund të përmbajë

një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë”.

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”.* Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”.* Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të pushonte çështjen nëse ajo do të ishte në shqyrtim e sipër. Pra, jemi në kushtet kur ankesa e paraqitur, është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat*

e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

Bazuar në nenin 36/4, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁵, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 40, datë 08.03.2023, të paraqitur nga shtetasi D. V., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)
(Fusha: Punësim)

⁵ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.